

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.09.2023*

**12.09.2023
Ora 16:36**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së kandidatëve për kryetar Bashkie në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, në seancë kemi dy çështje në rendin e ditës. Kemi hedhjen e shortit dhe miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë së Kukësit, të datës 24 shtator 2023 dhe pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i përmbajtjes së fletës së votimit për këto zgjedhje. Atëherë fillojmë pikën e parë me procedurat e shortit për renditjen e kandidatëve për kryetar bashkie në fletën e votimit.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, Komisioni Rregullator referuar nenit të 98, pika 5 të Kodit Zgjedhor, ka miratuar me vendimin numër 8, procedurën e hedhjes së shortit, për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletën e votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Në nenin 4, të këtij vendimi

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.09.2023*

është parashikuar procedura e hedhjes së shortit për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët. Për subjektet zgjedhore shorti është parashikuar me dy procese parashort dhe short, ndërsa për kandidatët është parashikuar në pikën 3, procedura vetëm për hedhjen e shortit të kandidatëve. Për këtë kemi përgatitur dy shirita letre me emrat e kandidatëve për kryetar të bashkisë. Duke qenë se kemi dy subjekte zgjedhore të regjistruara në zgjedhje, që kanë paraqitur kandidat për kryetar bashkie, kemi shënuar emrin e kandidatit përfaqësuar nga Partia Socialiste zotit Albert Halilaj, paloset shiriti i letrës futet në një gogël me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë në një ene transparente dhe shiriti tjetër është shënuar emri i përfaqësuesit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” zotit Emri Vata. Të dy goglat futen në një enë transparente, përzjehen nga një përfaqësues i KQZ-së për të vendosur sigurinë e barazisë në përzgjedhje.

- Tërhiqet gogla e parë dhe emri i parë që do të dalë nga gogla do mbajë numrin 1, në renditjen e fletës së votimit. Po, tërhiqet gogla! Albert Halilaj do të mbajë numrin 1 në fletën e votimit.

- Vazhdojmë me goglën tjetër, zoti Emri Vata do të mbajë numrin 2.

Atëherë nga rezultati i shortit përcaktohet se numri 1 do të jetë i Partisë Socialiste, ndërsa numri 2 i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, atëherë miratojmë rezultatin e shortit për renditjen e kandidatëve për kryetar bashkie në zgjedhjet e datës 24 shtator, për Bashkinë e Kukësit, ku i pari do të jetë i renditur kandidati i mbështetur nga Partia Socialiste dhe i dyti kandidati i mbështetur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Vendimi nr. 771

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.09.2023*

12.09.2023

Ora 16:39

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. P. Doçaj.**

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Atëherë, kalojmë tek pika e dytë që lidhet me miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit.

Z. Y. Merkaj: Duke ju referuar rezultatit të shortit të hedhur para pak minutash, Komisioneri do të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për renditjen e kandidatëve për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës. Sipas rezultatit të shortit numri 1 ishte zoti Albert Halilaj, ndërsa numri 2 u vendos zoti Emri Vata, ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Miratojmë dhe përmbajtjen e fletës së votimit, bazuar edhe në vendimin e Komisionit Rregullator, i cili ka vendosur mbi karakteristikat dhe specifikimet teknike të fletës së votimit. Bazuar dhe në rezultatin e shortit,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.09.2023*

përmbajtja e fletës së votimit ka: emrat e dy kandidatëve, shkronjat nistore të subjekteve mbështetës Partia Socialiste dhe Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, si dhe logot respektive, logon e Partisë Socialiste dhe logon e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. I pari në fletën e votimit do të renditet kandidati Albert Halilaj i mbështetur nga Partia Socialiste dhe i dyti Emri Vata mbështetur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Çështje të tjera nuk kemi, mirë faleminderit, seanca mbyllet.

Vendimi nr. 772

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

